

## KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot më 26/11/21 ortaku i shoqërisë “Carpathia Albania” sh.p.k. me NIPT L41629009A dhe me adresë Rruga “Pavarësia”, ndërtesa nr.1, Kati i Tretë, Zyra 340 dhe magazinë, Mëzez, Kashar, Tiranë, **Z. Burim Latifi**, lindur në Vranje, me datën 28/07/1984 identifikuar nga Leternjoftimi lëshuar nga Republika e Serbise datë 11/08/2015 me nr 007126278 dhe **Z. Frigul Milla** lindur në Tiranë më 18/09/1986 me Nr. Pasaportë BC8538508 dhe Nr. personal I60918044H, me adresë Rruga “Medar Shtylla” Kulla 5, Tiranë. Të dy palët si dhuruesi dhe pranuesi janë dakord me dhurimin e kuotave.

**Dhuruesi: Z. Burim Latifi**, lindur në Vranje, me datën 28/07/1984 identifikuar nga Leternjoftimi lëshuar nga Republika e Serbise datë 11/08/2015 me nr 007126278.

**Pranuesi: Z. Frigul Milla** lindur në Tiranë më 18/09/1986 me Nr. Pasaportë BC8538508 dhe Nr. personal I60918044H.

### Neni 1 Objekti kontratës

Objekt i kësaj kontrate është dhurimi i pjesëmarrjes në përqindje 100% të **Z. Burim Latifi** që zotëron tek shoqëria “Carpathia Albania” sh.p.k. për tek **Z. Frigul Milla**.

### Neni 2 Vlera e dhurimit

Palët bien dakord që vlera e dhurimit të 100% të pjesëmarrjes në përqindje që **Z. Burim Latifi** ka tek shoqëria “Carpathia Albania” sh.p.k. është ajo e vlerës 100.000,00. Këto kuota do i dhurohen **Z. Frigu Milla**. Palët nuk kanë asnjë pretendim kundrejt njëri-tjetrit, përsa i përket këtij neni.


### Neni 3 Kalimi i pronësisë

Hyrja në fuqi e kontratës do te realizohet kur nënshkruhet nga palët. Ekzekutimi i veprimeve për kalimin e plotë të pronësisë do të realizohet pranë Q.K.B.

### Neni 4 Të drejtat dhe detyrimet e dhuruesit

**Dhuruesi** merr përsipër, garanton dhe siguron pranuesin se deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe të nënshkrimit të Kontratës, kuotat e mësipërme janë:

1. Të lira nga cdo lloj barre dhe pengu;
2. Nuk jane objekt i ndonje konflikti gjyqësor
3. Nuk ka persona të tretë që të kenë pretendime në lidhje me pronësinë mbi këto kuota.



**Pranuesi** është i detyruar të paguaje tatimin mbi të ardhurat nga dhurimi, në qoftë se do të ketë, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

#### **Neni 5**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e pranuesit**

Ai ka të drejtë të gëzojë i qetë kuotat nga **Dhuruesi** dhe në rast të kundërt, të kërkojë nga ky i fundit të zgjidhë konfliktin që mund të vijë nga të tretët, për probleme të lindura përpara datës së dhurimit së kuotave.

#### **Neni 6**

#### **Interpretimi i kontratës në tërësi**

Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e terësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë kontratë.

#### **Neni 7**

#### **Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni**

Të gjitha mosmarreveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate, janë objekt shqyrtimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

**DHURUESI**

**Burim Latifi**



**PRANUESI**

**Frigul Milla**

